



PSH.nr.890/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, nw përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “MEDIATECH & PRINT” SH.P.K. – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “ARITECH”-Prishtinë - lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kompjuter dhe Laptop” me nr. të prokurimit: “632-20-4552-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “MEDIATECH & PRINT” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kompjuter dhe Laptop” me nr. të prokurimit: “632-20-4552-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kompjuter dhe Laptop” me nr. të prokurimit: “632-20-4552-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “MEDIATECH & PRINT” SH.P.K. – Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “MEDIATECH & PRINT” SH.P.K. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 04.11.2020 me nr. 890/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kompjuter dhe Laptop” me nr. të prokurimit: “632-20-4552-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 68, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 27.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK ka vepruar në kundërshtim me nenët 59, 72 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: nenin 1, neni 6, neni 7

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE “MEDIATECH & PRINT”

SH.P.K. lidhur me anulimin e ofertës së tyre nga AK – Komuna e Gjakovës – Gjakovë për çmimin e ofertës sqaron se OE Ankues ka ofertë me çmimin 19,260.00 € ndërsa OE i shpallur fitues është me çmimin 21,375.00€ Mirëpo në dokumentacionet të cilat janë shqyrtuar dhe verifikuar OE ankues **MEDIATECH & PRINT SHPK** është anuluar për arsye teknike profesionale lidhur me specifikacione teknike të cilat duhet përmbushur sipas kërkesave të specifikacioneve teknike të detyrueshme në Aneksin 1. Andaj pretendim **është pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: neni 68, neni 69

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE “**MEDIATECH & PRINT**” SH.P.K. mbi shkeljen e Nenin 68 dhe Nenin 69 , AK ka të drejtën e verifikimit të dokumentacioneve të dosjes së tenderit në përputhje me nenin 68 mbi gjendjen Ekonomike dhe Financiare dhe Nenin 69 mbi Aftesite Teknike dhe / ose Profesionale andaj sqarojmë se ky pretendim **është i pa bazuar**

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: neni 59, neni 60, neni 72

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE “**MEDIATECH & PRINT**” SH.P.K. mbi shkeljen e Nenin 59 , Neni 60 dhe Neni 72 në këtë procedurë të prokurimit, AK – Komuna e Gjakovës – Gjakovë ka vendosur si kriter në NJK dhe DT se Autoriteti Kontraktues do ti jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**, mirëpo OE duhet ti plotësoj minimumin e kërkesave të specifikacionit teknik në ankesin 1. AK duhet në përputhje me nenin 59 pika 4 dhe Nenin 72 të sqarohet lidhur me pretenidmin e AK – Letrën standarde - **TV nuk përkrah : Google Assistant**. OE “**MEDIATECH & PRINT**” SH.P.K. duhet AK ti ofron material sqarues të detajuar nga prodhuesi se produkti i tyre i plotëson të gjitha specifikacionet teknike sipas Aneksit 1. AK – Komuna e Gjakovës duhet ti vlerësoj, trajtoj të gjitha ofertat në përputhje me LPP. Duke përfshi edhe OE të rekomanduar për kontratë, dhe OE tjerë në këtë aktivitet të prokurimit – Llot 2 Furnizim me TV Smart.

AK dhe komisoni i vlerësimit duhet të kryejnë vlerësim profesional në përputhje me Nenin 59. Ky pretendim **është pjesërisht i bazuar.**

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK dhe komisoni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit duhet të kryejnë vlerësim profesional duke respektuar nenet 6, 7, 59, 60, 72 të LPP-së.



Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si

pjesërisht të bazuar dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim** për këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues me datë 30.11.2020 me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Po ju njoftojmë me mendimin e ekspertit shqyrtues të aktivitetit me nr “632-20-4552-1-2-1”

Po ju sqarojmë për pretendimet e operatorit ekonomik ankues që produkti i ofruar nga ky Operator nuk përkrah kërkesat e AK gjithashtu te bashkangjitur keni raportin dhe specifikat detale te dy



produkteve

për TV Smart

Pergjigje

Ne pergjigjen e pranuar nga OSHP eksperti ka cekur fare qart se OE ankues duhet te sqaroje se

produkti i tyre ofron dhe i plotëson te gjitha kërkesat e AK.

Ne specifikat e AK eshte kërkuar përkrahje e TV me google,Asistant, TV qe ofron OE ankes kemi kërkuar ne faqen zyrtare re Hisense per produktin ne fjale por nuk e perkrah kete opsion.

OE fitues ka TV Android i cili perfshin edhe Google Assistant dhe kemi verifikuar qe ploteson kërkesat e AK.

Ne nje kërkim te thjesht ne google verehet qart ku modelet si ky me lart nuk përkrahin google assistant.

Te bashkangjitur i gjeni edhe specifikat per dy modelet e TV si te OE ankues ashtu edhe OE fitues

Modeli i OE ankues Mediatec –Hisense 55” Smart TV H55B7100

Modeli i OE fitues Panamic ICT LLC- Ecolux EC55T2 SMART-HEVC, SMART TV , Android TV, WIFI

HISENSE H55B7100

Modeli: H55B7100

Përmasat: 55" (138,7 cm)

Rezolucioni: 4K Ultra HD (3840x2160)

Frekuenca: 60 Hz

Kriteri i Indeksit të fotografisë: 1500 PCI

Teknologjia HDR: HDR10, HDR10+

Funksioni: Natural Colour Enhancer

Procesori: Quad Core

Sistemi Operativ: VIDAA U3.0

Precision Colour

Motion Picture Enhancer

UHD Upscaler

Depth Enhancer

DTS Studio Sound

Pershkrimi i GJatë

Proporcioni i panelit: 16:9

Këndi i shikueshmërisë: 176 shkallë

Kontrasti: 4000:1

Teknologjia e dritës së prapme: DLED

Dekoderi: HEVC/H.265, H.264, MPEG4, MPEG2, VCI, MVC, VP9

Fuqia e prodhimit të zërit: 2x10 W

Teknologjia e zërit: DTS Studio Sound

Sistemi i zërit: Dolby Audio/MS12

Aplikacionet: Netflix, YouTube, Prime Video, Rakuten TV

Marrësi:

DVB-T2/T/C/S2/S

3x HDMI 2x USB Optical

Numri i hyrjeve (AV): 1

Numri i porteve Ethernet RJ45:1

Teknologjia Wi-Fi: 802.11ac,dual band/2.4G,5G

Bluetooth

Aplikacionet Smartphone

3D Digital fiiter

Vesa Montues murit standard: 200x200

Video Formatet: AVI, MP4, MKV, FLV, WMV, MOV,3GP, MPG, MPEG, VOB, WEBM, OGM, WMA

Audio Formatet: MP4, WMV, WMA, FLAC, MP2, MP3, AAC, WAV

Foto Formatet: JPEG, BMP, PNG, GIF, MPO


Pesha Bruto: 16,3 kg

Pesha Neto: 12,3 kg

Dimensionet e produktit te paketuar (WxHxD):137x86,3x15,5cm



Ecolux EC55T2 SMART - HEVC, SMART TV, Andorid TV, WIFI



Product page
Diagonal (") 55
Diagonal (cm) 139.7
Distinction picture
FHD (1920x1080) Yes
USB / HDD recording
Yes (also for HEVC / H.265) Multimedia
playback from USB Timer
Yes EPG Yes Teletext Yes
Teletext page memory 1000
CEC, CEC RC Passthrough
Sound
Stereo
Nicam Stereo
Number of speakers 2
SMART TV Android TV Yes
Internet browser
Open browser Opera software
Social networks (Facebook, Twitter,)
Yes
YouTube, Google, NETFLIX, ... Yes
Internet connection
WiFi (built-in), LAN
WiDi / MIRACAST (image mirroring)
Ano / Ano (Smartphone/Tablet Android,
iOS)
Product parameters
Summary
Producer Ecolux
Kind of TVs ICE
Screen diagonal 139.7 cm
Diagonal in inches 55 inches
DVB-T tuner Yes

DVB-T2	Yes	DVB-S	/	S2	Yes	DVB-C	/
--------	-----	-------	---	----	-----	-------	---

C2 Yes
 Smart TVs - Android Yes
 3D TVs No
 4K TVs Yes
 Picture
 Distinction 1920 x 1080
 Curved screen No
 HDR support Yes
 Inputs / outputs
 Scart No
 USB port Yes
 Number of HDMI inputs 3
 Headphone output Yes
 Number of USB inputs 2
 other functions
 Wi-Fi Yes
 HbbTV Yes
 LAN connector Yes
 H.265 HEVC codec support Yes
 USB recording Yes

Operatori Ekonomik me datë 30.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar ne se pari pajtohemi plotesisht me mendimin e ekspertit shqyrtues

Gjithashtu e kundërshtojmë bindshëm vendimin e AK-KOMUNA GJAKOVE ne lidhje me pretendimet e saja për ta shpallur fitues një OE i cili nuk i plotëson specifikat teknike kundrejt specifikave teknike te TV tone , gjithashtu AK përkrah këtë OE me specifikat e tv te cilat nuk korospondojne me specifikave e kërkuara . AK po e favorizon këtë OE i cili ka ofertuar me TV ECOLUX i cili nuk është brend botëror dhe për te cilin nuk mundeni askund ne internet ose ndonjë mjet kërkimi ta gjeni për këtë TV sepse nuk mundeni ta gjeni asnjë broshure apo katalog te këtij modeli te TV , sepse ky OE vetëm i ka shkruar specifikat si te dosjes sepse nuk përkrah asnjë element dhe specifik te specifikave teknike te dosjes se tenderit .

Gjithashtu ky brend i TV nuk krahasohet as nga specifikat teknike dhe as nga kualiteti me brendinë e ofruar nga kompania jone sepse e dijmë te gjithë brendi HISENSE ehte brend botëror i TV dhe mund ta gjeni ne google me modelin e ofertuar nga ne ose si broshure ose si katalog .

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SH.P.K. – Prishtinë, se AK e ka eliminuar për çmimin e ofertës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE ankues ka ofertë me çmimin 19,260.00 € ndërsa OE i shpallur fitues është me çmimin 21,375.00€. Mirëpo, në dokumentacionet të cilat janë shqyrtuar dhe verifikuar, OE ankues MEDIATECH & PRINT SHPK është eliminuar për arsye teknike profesionale lidhur me specifikacione teknike të cilat duhet përmbushur sipas kërkesave të specifikacioneve teknike të detyrueshme në Aneksin 1. Andaj pretendim është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SH.P.K. – Prishtinë, se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se AK ka të drejtën e verifikimit të dokumentacioneve të dosjes së tenderit në përputhje me nenin 68 mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe nenin 69 mbi aftësitë teknike dhe / ose profesionale. Andaj, ky pretendim është i pa bazuar

Lidhur me pretendimin e OE ankues "MEDIATECH & PRINT" SH.P.K. – Prishtinë, se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, 60 dhe 72 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se AK ka vendosur si kriter në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit se do ti jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, mirëpo OE duhet ti plotësoj minimumin e kërkesave të specifikacionit teknik në aneksin 1. AK duhet në përputhje me nenin 59 pika 4 dhe Nenin 72 të sqarohet lidhur me pretendimin e AK – Letrën standarde - TV nuk përkrah: Google Assistant. OE "MEDIATECH & PRINT" SH.P.K. duhet AK ti ofron material sqarues të detajuar nga prodhuesi se produkti i tyre i plotëson të gjitha

specifikacionet teknike sipas Aneksit 1. AK – Komuna e Gjakovës duhet ti vlerësoj, trajtoj të gjitha ofertat në përputhje me LPP. Duke përfshi edhe OE të rekomanduar për kontratë, dhe OE tjerë në këtë aktivitet të prokurimit – Llot 2 Furnizim me TV Smart. Po ashtu, AK dhe komisioni i vlerësimit duhet të kryejnë vlerësim profesional në përputhje me Nenin 59. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë të ofertave në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK Gjakovë;
- 1x1 OE "MEDIATECH & PRINT" SH.P.K. – Prishtine;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.